

Të dhënat e rinisë së Kosovës mundësohet nga SDC EYE Project dhe implementohet nga Helvetas dhe MDA.

EYE Enhancing Youth
Employment



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

K2.0

**TË DHËNAT
E RINISË SË
KOSOVËS**

K2.0

TË DHËNAT E RINISË SË KOSOVËS

| 1

**GJEJENI CILI RAJON
I KOSOVËS KA MË
SHUMË TË RINJ ?**

| 2

**GJEJENI KU ËSHTË
PAPUNËSIA MË E
LARTË?**

| 5

**CILAT INDUSTRI
PUNËSOJNË
MË SHUMË NË
KOSOVË?**

C O N T E N T |

3

**CILI RAJON E KA
PËRQINDJEN MË TË
MADHE TË TË RINJVE
TË PAPUNËSUAR?**

4

**ÇKA STUDIOJNË MË SË
SHUMTI TË RINJTË NË
UNIVERSITETET
PUBLIKE?**

6

**CILAT JANË DISA
NGA QENDRAT QË
OFROJNË MBËSHT-
JETJE PËR NDËR-
TIMIN E KARRIËRËS?**

7

**KU MUND T'I GJESH
MUNDËSI PËR
PUNËSIM, ARSIMIM,
GRANTE ETJ?**

1

**GJEJENI CILI RAJON
I KOSOVËS KA MË
SHUMË TË RINJ ?**

NUMRI I TË RINJVE TË MOSHËS 15-24, NË VITIN 2018:

Prishtina -> 114,114 (48% Gra, 52% Burra)
Mitrovica -> 37,313 (56% Gra, 52% Burra)
Peja -> 35,870 (53%Gra, 52% Burra)
Gjakova -> 33,687 (48% Gra, 52% Burra)
Gjilani -> 40,275 (48% Gra, 52% Burra)
Ferizaji -> 31,099 (48% Gra, 52% Burra)
Prizreni -> 80,306 (49% Gra, 52% Burra)



2

**GJEJENI KU ËSHTË
PAPUNËSIA MË E
LARTË?**

NUMRI I TË RINJVE TË PAPUNËSUAR TË MOSHËS 15-24, NË VITIN 2018:

Prishtina -> 394 (39% Gra, 61% Burra)
Mitrovica -> 199 (44% Gra, 56% Burra)
Peja -> 166 (48% Gra, 52% Burra)
Gjakova -> 79 (37% Gra, 63% Burra)
Gjilani -> 66 (58% Gra, 42% Burra)
Ferizaji -> 172 (48% Gra, 52% Burra)
Prizreni -> 319 (40% Gra, 60% Burra)



3

**CILI RAJON E KA
PËRQINDJEN MË TË
MADHE TË TË RINJVE TË
PAPUNËSUAR?**

% E TË RINJVE TË PAPUNËSUAR NË ZYRAT E PUNËSIMIT NË KOSOVË, NË 2018

Prishtina -> 0.3% (0.3% Gra, 0.4% Burra)
Mitrovica -> 0.5% (0.4% Gra, 0.7% Burra)
Peja -> 0.5% (0.4% Gra, 0.5% Burra)
Gjakova -> 0.2% (0.2% Gra, 0.3% Burra)
Gjilani -> 0.2% (0.2% Gra, 0.1% Burra)
Ferizaji -> 0.6% (0.5% Gra, 0.6% Burra)
Prizreni -> 0.4% (0.3% Gra, 0.5% Burra)

(Burimi: Ilogaritjet e Kosovo 2.0)



Universitetet Publike, 2017/2018 (BA+MA+studentët e Doktoratës)

Universiteti i Prishtinës: 41,208 (58% Gra, 42% Burra)

Universiteti i Mitrovicës: 3,185 (55% Gra, 45% Burra)

Universiteti i Pejës: 12,693 (45% Gra, 55% Burra)

Universitetit i Gjakovës: 2,373 (71% Gra, 29% Burra)

Universiteti i Gjilanit: 3,235 (67% Gra, 35% Burra)

Universiteti i Ferizajit: 1,302 (51% Gra, 47% Burra)

Universiteti i Prizrenit: 5,778 (59% Gra, 42% Burra)

4

**ÇKA STUDIOJNË MË SË
SHUMTI TË RINJTË NË
UNIVERSITETET
PUBLIKE?**

Fushat që studiohen më së shumti në universitetet publike, në 2017/2018:

-Universiteti i Prishtinës, (BA+MA+ studentët e doktoratës)

Fakulteti Ekonomik (8,696, 53% Gra, 47% Burra)

Fakulteti Juridik (5,125, 60% Gra, 40% Burra)

Fakulteti i Mjekësisë (3,849, 60% Gra, 40% Burra)

Fakulteti Filozofik (3,780, 65% Gra, 35% Burra)

Fakulteti i Edukimit (3,758, 89% Gra, 11% Burra)

-Universiteti i Mitrovicës (BA+MA)

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (949, 41% Gra, 59% Burra)

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore (618, 58% Gra, 42% Burra)

Faculteti i Edukimit (615, 94% Gra, 6% Burra)

(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

-Universiteti i Pejës (BA+MA)

Fakulteti i Biznesit (6,046, 47% Gra, 53% Burra)

Fakulteti Juridik (3,835, 43 Gra, 57% Burra)

Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis (1,862, 44% Gra, 56% Burra)

-Universiteti i Gjakovës (BA)

Edukim / Fillor (597, 82% Gra, 18% Burra)

Edukim / Parashkollor (501, 68% Gra, 32% Burra)

Mjekësi / Infermieri (349, 73% Gra, 27% Burra)

-Universiteti i Gjilanit (BA+MA)

Juridik (940, 61% Gra, 39% Burra)

Edukim / Fillor (559, 87% Gra, 13% Burra)

Ekonomik / Menaxhment (489, 52% Gra, 48% Burra)

Ekonomik / Banka, Financa dhe Kontabilitet (468, 59% Gra, 41% Burra)

-Universiteti i Ferizajit (BA+MA)

Fakulteti i Menaxhmentit (376, 56% Gra, 44% Burra)

Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit (356, 55% Gra, 45% Burra)

Fakulteti i Arkitekturës dhe Teknologjisë së Drurit (341, 50%
Women, 50% Burra)

-Universiteti i Prizrenit (BA+MA)

Administrim Biznesi (848, 48% Gra, 52% Burra)

Juridik (998, 49% Gra, 51% Burra)

Programi Fillor (826, 86% Gra, 14% Burra)

Shkollat profesionale, 2017/2018

Prishtina: 13,212 nxënës
Mitrovica: 6,731 nxënës
Peja: 4,943 nxënës
Gjakova: 3,185 nxënës
Gjilan: 4,616 nxënës
Ferizaj: 4,489 nxënës
Prizren: 8,298 nxënës

Shkollat e mesme, 2017/2018

Prishtina: 11,549 nxënës
Mitrovica: 4,061 nxënës
Peja: 3,569 nxënës
Gjakova: 2,850 nxënës

5

**CILAT INDUSTRI
PUNËSOJNË MË SHUMË
NË KOSOVË?**

SEKTORËT / INDUSTRITË QË PUNËSOJNË MË SHUMË NË 2018

Punësimi sipas aktivitetit ekonomik [Në mijëra dhe %], 2018						
	(000's)			(%)		
	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra	Totali
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	11.6	0.7	12.3	4.2	1.0	3.5
Minierat dhe guroret (industria nxjerrëse)	3.1	0.1	3.2	1.1	0.1	0.9
Industria përpunuese	31.3	4.5	35.9	11.4	6.1	10.3
Furnizimi me rrymë, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	6.2	0.1	6.3	2.3	0.1	1.8
Furnizimi me ujë, kanalizim, aktivitetet e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	4.1	0.3	4.4	1.5	0.4	1.3
Ndërtimtaria	40.6	0.9	41.5	14.8	1.2	11.9
Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	46.0	13.1	59.0	16.8	17.7	17.0
Transporti dhe magazinimi	10.4	1.1	11.5	3.8	1.4	3.3
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	21.2	2.7	23.9	7.7	3.6	6.9

Informimi dhe komunikimi	9.6	2.3	12.0	3.5	3.2	3.4
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	4.7	2.4	7.1	1.7	3.2	2.0
Aktivitetet e patundshmërisë	0.3	0.0	0.4	0.1	0.0	0.1
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	4.2	1.9	6.2	1.5	2.6	1.8
Shërbimet administrative dhe mbështetëse	7.9	2.1	10.0	2.9	2.8	2.9
Administrimi publik dhe mbrojtja, sigurimi social i detyrueshëm	19.5	4.8	24.2	7.1	6.5	7.0
Arsimi	23.3	16.1	39.4	8.5	21.8	11.3
Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	10.2	9.9	20.1	3.7	13.4	5.8
Artet, argëtimi dhe rekreacioni	4.0	0.6	4.6	1.5	0.8	1.3
Aktivitete tjera të shërbimit	13.0	3.8	16.8	4.8	5.1	4.8
*Veprimtaritë ekonomike familjare si punëdhënës	1.0	5.1	6.0	0.4	6.8	1.7
Veprimtaritë e trupave dhe organizatave ndërkombëtare	1.9	1.5	3.4	0.7	2.0	1.0
Gjithsej	274.1	74.0	348.2	100.0	99.8	100.0

(Source: Kosovo Agency of Statistics)

MIGRIMI NË KOSOVË, 2017

	Migrimi ndërkombëtar - Imigrimi	Migrimi ndërkombëtar - Imigrimi	Migrimi kombëtar - Imigrimi	Migrimi kombëtar - Migracioni
Prishtina	1716	2084	4458	3483
Mitrovica	521	1706	800	1301
Peja	532	596	739	771
Gjakova	424	1260	447	578
Gjilan	699	1396	694	960
Ferizaj	929	840	850	836
Prizren	1011	3381	1388	1447

(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)



6

**CILAT JANË DISA NGA
QENDRAT QË
OFROJNË MBËSHTJETJE
PËR NDËRTIMIN E
KARRIERËS?**

▪ **Qendrat universitare për zhvillim të karrierës**

- Universiteti i Prishtinës: Qendra për Zhvillim të Karrierës Universiteti i Prishtinës; Innovation Lab Kosovo; Venture UP
- Universiteti i Pejës: Qendra për Zhvillimin e Karrierës Universiteti Haxhi Zeka

▪ **Zyrat rajonale të punësimit**

- Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj dhe Prizren

▪ **Qendrat për Aftësim Profesional**

- Janë tetë Qendra të Aftësimit Profesional (QAP) brenda Agjencisë së Punësimit, të cilat veprojnë në Prishtinë, Pejë, Gjilan, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Doljane. Këto qendra ofrojnë trajnime për personat e regjistruar si të papunë dhe/ose punëkërkuar, dhe ata që janë të interesuar në mbajtjen e trajnimeve për orientim si dhe zhvillim në karrierë në të gjitha zyrat e punësimit nëpër komuna. Trajnimet profesionale bëhen në dy

mënyra: trajnim institucional në Qendrat e Aftësisimit Profesional; dhe trajnim i kombinuar (QAP dhe kompani). Kohëzgjatja e trajnimit është 3-6 muaj dhe kurrikula e tij mbulon 30% teori dhe 70% praktikë. Kandidati duhet t'i kalojë testet pas çdo moduli si dhe testin përfundimtar në fund të trajnimit në mënyrë që të marrë një çertifikatë mbi aftësitë dhe kompetencat e marra.

Trajnimi institucional nënkupton trajnim falas që ofrohet nga 8 Qendrat e Aftësisimit Profesional për të papunët dhe/apo punëkërkuesit në fusha/profesione të caktuara. Qëllimi i trajnimeve institucionale është ngritja apo krijimi i aftësive profesionale në mënyrë që të rrisin perspektivën e pjesëmarrësve në punësim ose ruajtjen e punësimit të tyre.

Trajnimi i Kombinuar nënkupton bashkëpunimin me kompanitë biznesore ku Qendrat e Aftësisimit Profesional e mbulojnë pjesën teorike në fusha/profesione të caktuara ndërsa kompanitë of-

rojnë njohuri praktike dhe mundësinë për ta praktikuar njohurinë teorike, nën mbikëqyrjen e një të punësuarit në kompaninë e caktuar.

Industritë/profesionet në Qendrat e Aftësimit Profesional:

- Prishtinë: Instalim i Ujësjetës dhe i Ngrohjes Qendrore; Administrim biznesi dhe vetpunësim; asistent administrativ/kontabilitet; Furrтари; Pasticëri; Teknologji dhe Elektronikë Industriale; Ndërtimtari; Servisim i Pajisjeve për Zyrë; Auto elektrikë; Rrobaqepësi

- Prizren: Kuzhinier;Kamarier; Auto elektrikë; Hidraulik dhe Pneumatik; Saldim; Administrim biznesi/vetpunësim; Elektronikë industriale; Servisim i teknikës së bardhë; Teknologji; Rrobaqepësi; Përpunimi i qumështit; Floktari; Furrтари

- Pejë: Asistent administrativ/kontabilitet; Administrim biznesi, Elektroinstalime; Ndërtimtari; Instalime të ujësjetës; Agrokulturë; Kuzhinë; Saldim; Zdrukthtari; Ndërmarrësi/vetpunësim

- Ferizaj: Zdrukthtari; Instalime elektrike; Ndërtimtari; Saldim/In-

stalime të sistemit të furnizimit me ujë; Teknologji; Administrim biznesi/vetpunësim; Mirëmbajtës i objekteve; Përdorim i kompjuterit; Kuzhinë; Hoteleri

- Gjilan: woodwork; Saldim; Përdorimi i kompjuterit; Administrim biznesi/Vetpunësim; Dizajn grafik; Kuzhinieri

- Gjakovë: Asistent administrativ/kontabilitet; Elektroinstalime; Ndërmarrësi/vetpunësim; Zdrukhtari; Administrim biznesi; Floktari; Rrobaqepësi

- Mitrovicë: Zdrukhtari; Teknologji; Tekstil; Ndërtimtari; Saldim; Administrim biznesi/Vetpunësim; Kuzhinë

- Doljane: Zdrukhtari; Kuzhinë; Tekstil; Saldim; Administrim biznesi

7

**KU MUND T'I GJESH
MUNDËSI PËR PUNËSIM,
ARSIMIM, GRANTE ETJ?**

Vegëza të dobishme:

Busulla: <https://busulla.com>

Platforma zyrtare e MASHT-it për orientim profesional, edukim dhe këshillim në karrierë.

Kastori: <https://kastori.net>

Portal për punë, grante kontrata, bursa, trajnime, konferenca

Sistemi Informativ i Tregut të Punës: (SITP): <http://sitp.rks-gov.net>

Sistemi Informativ i Tregut të Punës (SITP) është një sistem gjithëpërfshirës për grumbullimin, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit sasior dhe cilësor mbi gjendjen dhe trendet në ofertën dhe kërkesën e punës si dhe mbi faktorët që shkaktojnë disbalancin në mes tyre, duke përfshirë sektorë të ndryshëm ekonomik, profesione, dhe zonat e një vendi. SITP mbulon të dy nivelet makro dhe mikro (profesionale) të ofertës

dhe kërkesës së punës dhe sugjeron që nevoja për të dhëna dhe informacion mbi disbalancin që del si përfundim në mes të ofertës dhe kërkesës së punës, nga njëra anë në formën e furnizimit të tepërt (që çon në papunësi) dhe nga ana tjetër furnizimi i papërshtatshëm (në nivel profesional) duke rezultuar në mungesa të krahut të punës.

Sistemi Informativ i Tregut të Punës (SITP) mbledhë një sërë të dhënash nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (rreth regjistrimit të popullsisë, Anketa e Fuqisë Punëtore), nga MASHT (statistikat e arsimit), MPMS (të papunësuarit e regjistruar, Përfituesit e asistencës sociale, vendet e lira të punës etj), nga Administrata Tatimore (shifrat zyrtare të punësimit); MTI (regjistri i bizneseve) në një sistem të përbashkët, me qëllim që të ofrojë informacion të përditësuar mbi trendin dhe tendencat në tregun e punës në Kosovë.

Përveç kësaj, në SITP është shtuar edhe Moduli i Informatave

të Karrierës i cili siguron (i) informata mbi sektorin ekonomik dhe trendet e profesioneve; (ii) kërkesat e shkathtësive dhe përmbajtjes profesionale; (iii) informata mbi mundësitë për të mësuar (ofertat për arsim dhe trajnime profesionale); (iv) ekonomia formale aktuale dhe vendet e punës, vendet e lira të punës dhe kushtet e punës; (v) mundësi të tjera të punësimit si vetëpunësimi/ndërmarrësia.



K2.0

TË DHËNAT E RINISË SË KOSOVËS

